

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Sot më 01.09.2025 ortaku i **vetëm**:

Znj. Carmela Goretti CHIOCCA, nenshtetase Italiane, lindur me 21.04.1978, ne Pozzuoli Napoli, banuese ne Via Caio Vestorio, 10- Pozzuoli (NA), identifikuar me pasaporte numer YC5577599, madhore dhe me aftësi të plotë juridike për të vepruar.

Në bazë të këtij akti, Znj. Chiocca vendos të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Statut si vijon:

KREU I

EMËRTIMI – SELIA – KOHEZGJATJA

Neni 1. Emërtimi

Krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e quajtur **“G.C.C SOLUTION” SHPK** (në vijim e referuar si “shoqëria”).

Neni 2. Forma Ligjore

2.1. Shoqëria ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar dhe është themeluar sipas ligjit tregtar shqiptar.

2.2. Shoqëria mund të ndryshojë formën ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri.

2.3. Shoqëria ushtron veprimtarinë në përputhje me këtë statut.

2.4. Për çështjet e papërcaktuara në statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 3. Selia

3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në **Tiranë, Rruga Reshit Çollaku, Pall. 1 H.1, ap. 8-1010.**

3.2. Zhvendosja e selisë do të bëhet me vendim të asamblesë së ortakëve.

3.3. Shoqëria mund të krijojë degë dhe filiale brenda dhe jashtë vendit.

Neni 4. Logoja dhe vula

4.1. Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj, të cilat mund t’i përdorin administratorët e saj.

4.2. Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me normativën shqiptare në fuqi.

4.3. Të gjitha dokumentet e lëshuara nga shoqëria do të kenë logon dhe vulën.

Neni 5. Kohaezgjatja

Shoqëria themelohet për kohë të pacaktuar dhe bëhet aktive pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



KREU II

OBJEKTI – KAPITALI SHOQËRISË

Neni 6. Objekti Shoqërisë

Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit dhe ka për objekt aktivitetet e mëposhtme:

- a) Importimi, eksportimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, përfaqësimi, depozitimi dhe shpërndarja e materialeve hekurishte, metalike, të çdo lloji dhe forme, të lëndëve djegëse të ngurta, të lëngshme dhe të gazta, vajrave lubrifikues, produkteve të naftës dhe derivateve të tyre, si dhe çdo produkti tjetër të ngjashëm ose të lidhur. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu veprimtari të ndërmjetësimit tregtar dhe logjistik të lidhura me operacionet e shitblerjes, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet tregtare, industriale, mobiliare dhe imobiliare të nevojshme ose të dobishme për arritjen e objektit shoqëror, duke respektuar legjislacionin në fuqi.
- b) Prodhim për palë të treta në sistemin e regjimit të përkohshëm, montim ose projektim, ndërtim dhe shitje, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të dyerve, dritareve dhe elementeve të tjerë të ngjashëm prej çdo materiali, të lidhura me aktivitetet e rehabilitimit energjetik. Këto shitje të dyerve dhe dritareve, së bashku me pajisje dhe makineri specifike, mund të jenë të prodhuara nga vetë shoqëria ose të prodhuara nga të tretët, dhe do t'u drejtohen kryesisht prodhuesve të dyerve/dritareve dhe tregtarëve kombëtarë ose ndërkombëtarë. Shoqëria mund t'u japë të tretëve njohuritë përkatëse (know-how), si dhe përdorimin e çdo patenti, pjesërisht ose ekskluzivisht, që lidhet me shpikjet e fituara ose të krijuara nga stafi i saj.
- c) Asistencë në distancë për përgatitjen e ofertave për klientët, skica ose dokumente të tjera; projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave të reja të organizuara teknikisht dhe/ose i njësive prodhuese vendore, edhe për llogari të palëve të treta dhe, nëse është e nevojshme, vetëm përmes dhënies së njohurive të saj (know-how), si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, në sektorët tregtarë ku shoqëria operon ose që janë normalisht pjesë e kompetencave të saj.
- d) Blerja në çdo formë, përfshirë në ankand; shitja, këmbimi dhe transferimi me kundërshpërblim në përgjithësi, si dhe dhënia me qira jo-financiare e pasurive të paluajtshme bujqësore dhe urbane, duke përfshirë toka dhe ndërtesa që do të prishen dhe/ose rindërtohen.
- e) Ndërtimi, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja, për llogari të vet ose të palëve të treta, e ndërtesave të destinuara për çdo përdorim; kryerja e punimeve ndërtimore në përgjithësi, dhe në veçanti të punimeve që lidhen me instalimin e dyerve, dritareve dhe elementeve të tjerë të ngjashëm.
- f) Kryerja e veprimtarive logjistike dhe ndihmëse për të gjitha ato të mësipërmet, duke përfshirë mobilimin dhe pajisjen e ambienteve të ndryshme.

Shoqëria, vetëm me qëllim të realizimit të objektit shoqëror, mund të:

kryejë operacione import–eksport dhe të marrë agjenci e përfaqësi me dhe pa depo, për produkte italiane dhe të huaja të çdo lloji;

kryejë operacione mobiliare, imobiliare, tregtare, industriale dhe financiare (këto të fundit jo në mënyrë kryesore dhe jo ndaj publikut);



marrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesa dhe pjesëmarrje, jo me qëllim tregtimi, në shoqëri, konsorciume dhe ndërmarrje me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin dhe/ose të konsideruar strategjikisht të rëndësishëm;

kërkojë financime dhe të japë garanci të ndryshme, përfshirë avale, fidejussione, hipoteka dhe garanci të tjera në përgjithësi, edhe në favor të palëve të treta dhe për detyrimet e tyre, në veçanti në favor të shoqërive të kontrolluara, të lidhura ose që bëjnë pjesë në të njëjtin grup, në mënyrë që ky aktivitet të mos konsiderohet si aktivitet financiar ndaj publikut; të blejë ndërmarrje ose degë ndërmarrjesh me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin.

Shoqëria mund gjithashtu të marrë, jo me qëllim tregtimi, interesa dhe pjesëmarrje në shoqëri ose ndërmarrje të çdo lloji me objekt të ngjashëm, të afërt ose të lidhur me të vetin, të japë fidejussione dhe garanci të tjera në përgjithësi, përfshirë garanci reale. Pronësia e çdo patenti të krijuar nga veprimtari kërkimore e lidhur me porosi të veçanta do të rregullohet nga kontrata të posaçme me porositësit. Të gjitha këto veprimtari, si dhe çdo veprim tjetër që shërben për realizimin e aktivitetit kryesor, duhet të kryhen brenda kufijve dhe në respektim të ligjeve që rregullojnë ushtrimin e tyre.

Neni 7. Kapitali Shoqëror

7.1. Kapitali fillestar është përcaktuar në shumën **1.000.000 lekë (ekuivalent i 10.000 euro)**.

7.2. Kapitali ndahet në një kuotë të vetme prej 1.000.000 lekësh dhe është në pronësi të themeluesit të vetëm.

7.3. Përgjegjësia e themeluesit është e kufizuar në vlerën e kuotës së kapitalit të tij.

Neni 8. Rritja e kapitalit shoqëror

Kapitali mund të rritet pa kufizime, në çdo moment, një ose më shumë herë.

Rritja e kapitalit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të asamblesë, unanimisht, dhe vendimmarrja përkatëse e Asamblesë së Ortakëve duhet të miratohet me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

Rritja e kapitalit shoqëror mund të bëhet duke nënshkruar rritjen e kuotës në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së kapitalit të zotëruar.

Neni 9. Ulja e kapitalit shoqëror

9.1. Shoqëria mund të ulë kapitalin shoqëror me vendim paraprak të asamblesë, me unanimitet, por jo nën nivelin minimal të parashikuar nga ligji.

9.2. Ulja e kapitalit përballohet nga secili ortak proporcionalisht me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që zotëron.

Neni 10. Transferimi i kuotave

10.1. Kuotat janë të transferueshme lirisht midis ortakëve të shoqërisë.

10.2. Në rast të shitjes ose transferimit në çdo formë, me shpërblim ose falas, përfshirë edhe dhurimin e kuotave për persona të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet t'u ofrohen me përparësi ortakëve të tjerë.

10.3. Në këtë rast, ortaku shitës duhet të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë, me letër të rekomanduar me kthim përgjigjeje, për vullnetin e tij për të shitur, duke treguar çmimin, kushtet, mënyrat, emrin dhe të dhënat e blerësit, si dhe afatet e transferimit. E drejta e përparësisë duhet të shtrihet mbi të gjithë kuotën



e ofruar për shitje.

10.4. Ortakët do të kenë 15 ditë nga marrja e letrës së rekomanduar për të njoftuar ortakun shitës mbi vullnetin e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e përparësisë. Pas skadimit të afatit, e drejta e përparësisë konsiderohet e hequr dorë.

10.5. Në rast se oferta pranohet nga më shumë ortakë, kuota e ortakut shitës do të ndahet ndërmjet tyre në masë proporcionale me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që zotëron secili prej tyre, përveçse kur palët bien dakord ndryshe.

10.6. Në asnjë rast ofertuesi nuk është i detyruar të pranojë një ushtrim vetëm të pjesshëm të së drejtës së përparësisë.

10.7. Në rast mosushtrimi të së drejtës së përparësisë, kuotat mund t'u transferohen të tretëve, plotësisht ose pjesërisht, me vendim paraprak pozitiv të asamblesë së ortakëve.

TITULLI III

ORGANET SHOQËRORE

Neni 11. Asambleja e ortakëve

Organ vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e ortakëve.

11.1. Në kompetencë të asamblesë së ortakëve janë, për shembull dhe jo vetëm, vendimet për këto çështje:

- Miratimi i politikave tregtare të shoqërisë dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre nga administratori ose administratorët, përfshirë raportet financiare;
- Rritja dhe ulja e kapitalit shoqëror;
- Shkrirja ose bashkimi me shoqëri të tjera;
- Ndryshimi i statutit të shoqërisë;
- Ndryshimi i selisë ligjore dhe emrit të shoqërisë;
- Emërimi i ekspertëve kontabël, fiskalë, kur është e nevojshme;
- Shitja ose transferimi i kuotave të kapitalit shoqëror tek palë të tjera;
- Ristrukturimi dhe shkrirja e shoqërisë;
- Emërimi dhe shkarkimi i administratorit ose administratorëve;
- Miratimi i bilancit dhe raportit të administratorit/ëve;
- Vendimet për shpërndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- Transformimi i formës ligjore të shoqërisë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga statuti ose ligji.

11.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në asamble, të shprehë mendimin e tij dhe të japë votën në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së kapitalit që zotëron.

11.3. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, edhe jo ortak, i pajisur me prokurë të thjeshtë me shkrim, përmes së cilës mund të ushtrojë votën. Ortaku nuk mund të japë prokurë për një pjesë të kapitalit, nëse voton vetë për pjesën tjetër.



Neni 12. Thirrja e asamblesë, kuorumi dhe vendimmarrja

12.1. Asambleja duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda 120 ditëve kalendarike nga mbyllja e ushtrimit financiar, për miratimin e bilancit, raporteve të administratorëve dhe raportit të ekspertit kontabël, nëse bilanci i nënshtrohet rishikimit.

12.2. Asambleja mund të thirret gjithashtu në çdo kohë nga njëri prej Administratorëve, si dhe nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit shoqëror.

12.3. Asambleja duhet të thirret me letër të rekomanduar me kthim përgjigjeje, e cila i dërgohet ortakëve në adresën e përcaktuar në këtë statut, si dhe ekspertit kontabël, nëse është emëruar, të paktën 7 ditë para datës së caktuar për asamble.

12.4. Thirrja duhet të përmbajë tregimin e llojit të asamblesë, çështjet që do të trajtohen dhe miratohen si rend dite, vendin, orën, datën e mbledhjes së parë dhe të dytë.

12.5. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së shoqërisë.

12.6. Në rast të mosmbajtjes së asamblesë në thirrjen e parë, për shkak të mungesës së kuorumi të parashikuar në këtë nen, Asambleja do të thirret brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

12.7. Lejohet që mbledhjet e asamblesë të mbahen me telekonferencë ose videokonferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u jepet mundësia të ndjekin diskutimet dhe të ndërhyjnë në kohë reale gjatë trajtimit të çështjeve. Kur këto kushte plotësohen dhe pasqyrohen në procesverbalin e asamblesë, ajo konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe ku duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.

12.8. Asambleja do të konsiderohet e thirrur dhe e përbërë në mënyrë të rregullt edhe pa respektuar formalitetet e thirrjes, nëse është i pranishëm ose i përfaqësuar i gjithë kapitali shoqëror.

12.9. Vendimet e Asamblesë së ortakëve, që kërkojnë shumicë të thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakë me të drejtë vote që përfaqësojnë më shumë se 30% të të gjithë kapitalit shoqëror.

12.10. Vendimet e Asamblesë së ortakëve, që kërkojnë shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm 51% e të gjithë kapitalit shoqëror. Përgjatë bën vendimet për rritje dhe ulje të kapitalit shoqëror, të cilat duhet të merren vetëm me praninë e 100% të kapitalit shoqëror dhe me vendim unanim.

12.11. Asambleja vendos për ndryshimin e statutit, riorganizimin dhe shpërbërjen e shoqërisë, shpërndarjen e fitimit, me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve që përfaqësojnë kapitalin e shoqërisë.

12.12. Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga të gjithë ortakët e pranishëm dhe nga sekretari i mbledhjes.

12.13. Sekretari emërohet nga Asambleja në fillim të mbledhjes dhe mund të jetë edhe jo ortak.

Neni 13. Administrimi

13.1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

13.2. Në rast se shoqëria administrohet nga më shumë se një administrator, ata ushtrojnë kompetencat e tyre së bashku ose veçmas, sipas përcaktimit në procesverbalin e asamblesë për emërimin e administratorit të dytë.

13.3. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 vitesh.

13.4. Administratori mund t'ia delegojë kompetencat e tij palëve të treta, edhe një ortaku të shoqërisë ose një grupi personash, tërësisht ose pjesërisht, sipas këtij statuti ose në varësi të kushteve dhe situatës.

13.5. Delegimi mund të bëhet me prokurë noteriale kur kërkohet detyrimisht për shkak të natyrës së veprimit, ose me një autorizim me vulë dhe nënshkrim të Administratorit, duke specifikuar çështjen



përkatëse.

13.6. Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat pa kufizim, në përputhje me nenin 95 dhe vijues të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

13.7. Administratori i parë i shoqërisë emërohet znj. **CHIOCCA Carmela Goretti**, shtetase italiane, e lindur më 21.04.1978 në Pozzuoli (NA), banuese në Via Caio Vestorio, 10 – Pozzuoli, Napoli, e identifikuar me pasaportë nr. YC5577599, për një periudhë prej 5 vitesh, me të drejtë rinovimi pas miratimit të Asamblesë.

Neni 14. Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Në mënyrë të veçantë, viti i parë i aktivitetit fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 15. Shkrirja dhe likuidimi i shoqërisë

Shkrirja e shoqërisë mund të bëhet për këto arsye:

- a) Përfundimi i afatit të veprimtarisë së parashikuar në aktin e themelimit;
- b) Me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- c) Hapja e procedurës së falimentimit;
- d) Me vendim gjykate.

Likuidatori është i detyruar të përgatisë pasqyrën e aktiveve dhe pasiveve, të kryejë operacionet e nevojshme të likuidimit dhe të përcaktojë kohën për mbylljen e procesit. Në fund, ortakët informohen për gjendjen përfundimtare dhe mbylljen e likuidimit.

Neni 16. Të ardhurat, ndarja e dividendëve

Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e objektit të saj.

Fitimi, pas mbylljes së ushtrimit dhe pagesës së taksave, mund të shpërndahet ndërmjet ortakëve.

Neni 17. Klauzola përfundimtare

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë aktivitetit të shoqërisë, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim, palët bien dakord t’i drejtohen Arbitrazhit tregtar pranë Qendrës Shqiptare të Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar, përveç rasteve kur kompetente sipas ligjit është gjykata shqiptare në Tiranë ose në vendin ku shoqëria mund të ketë filiale.

Ky statut është hartuar në tre kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe italiane, me të njëjtën vlerë juridike.

01/02/2025

ORTAK I VETËM I SHOQËRISË

Carmela Goretti CHIOCCA

STATUTO DI SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA

Oggi il, 01.09.2025, il socio unico fondatore,

Sig.ra CHIOCCA Carmela Goretti, cittadina Italiana, nata il 21.04.1978, a Pozzuoli(NA), residente in Via Caio Vestorio, 10- Pozzuoli, Napoli, identificata dal passaporto con numero YC5577599, maggiorenne con piena capacità giuridica di agire, decide di costituire la società a responsabilità limitata nelle condizioni di presente Statuto come segue:

TITOLO I

DENOMINAZIONE – SEDE-DURATA

Art.1. Denominazione

È costituita la società a responsabilità limitata avente la seguente denominazione sociale: “**G.C.C SOLUTION**” SRL. (in seguito la società)

Art. 2. Forma Legale

2.1. La società ha la forma di Società a Responsabilità limitata ed è stata costituita secondo le previsioni della legislazione commerciale albanese.

2.2. La società può trasformare la sua forma legale nel rispetto della legislazione albanese in vigore.

2.3. La società esercita la sua attività nel rispetto di questo statuto.

2.4. Per quanto non previsto da questo statuto, verranno applicate le disposizioni della legge no. 9901, del 14.04.2008, “Sui commercianti e le società commerciali”.

Art. 3. Sede

3.1. La società ha sede nel comune di Tirana, **Rruga Reshit Collaku, Pall.1 H.1, ap.8-1010**

3.2. Il trasferimento della sede della società, avverrà con la delibera dell’assemblea dei soci.

3.3. La società può istituire sedi secondarie, filiali od altre unità locali rappresentative sia entro il territorio dello stato albanese, sia all’estero.

Art. 4. Logo e timbro

4.1. La società avrà un suo logo ed il suo timbro. Competenti ad usare il timbro della società saranno i suoi amministratori.

4.2. La forma e le misure del timbro saranno definite in accordo con la normativa albanese in vigore.

4.3. Tutti i documenti emessi dalla società dovranno recare il logo ed il timbro della società.

Art. 5. Durata della società

La durata della società è stabilita a tempo indeterminato. La società diventa attiva, con la sua registrazione preso il registro delle imprese in Centro Nazionale delle Società in Albania.



TITOLO II

OGGETTO – CAPITALE SOCIALE

Art. 6. Oggetto sociale

La società potrà svolgere la propria attività sia in Albania che all' Estero ed ha per oggetto le seguenti attività:

- a) importazione, esportazione, commercio all'ingrosso e al dettaglio, rappresentanza, deposito e distribuzione di materiali ferrosi, metallici, di qualsiasi tipo e forma, combustibili solidi, liquidi e gassosi, oli lubrificanti, prodotti petroliferi e derivati, nonché di ogni altro prodotto affine o connesso. Potrà inoltre svolgere attività di intermediazione commerciale e logistica connesse alle operazioni di compravendita, sia in Albania che all'estero, e compiere tutte le operazioni commerciali, industriali, mobiliari e immobiliari necessarie o utili per il conseguimento dell'oggetto sociale, nel rispetto delle normative vigenti.
- b) Produzione per terzi nel sistema di regime temporanea, assemblaggio o progettazione, costruzione e vendita, diretta o indiretta, di serramenti, infissi di qualsiasi altro materiale connesso alle attività di riqualificazione energetica. Tali vendite di infissi unitamente ad attrezzature e macchinari specifici possono essere di propria produzione o fatti produrre all'esterno, e saranno rivolti principalmente a serramentisti e rivenditori nazionali o esteri. La società potrà concedere a terzi i relativi know how, così come l'utilizzo di eventuali brevetti, parziali o in esclusiva, inerenti ad invenzioni acquisite o create dal proprio staff;
- c) assistenza in distanza di preparazione offerte per clienti, disegni, o altro; progettazione e costruzione di nuovi stabilimenti tecnicamente organizzati e/o di unità produttive locali, anche per conto terzi ed anche, se del caso, mediante la sola concessione del proprio know how, sia in Albania che all'estero, nei settori merceologici di appartenenza e di normale competenza della società;
- d) acquisto a qualsiasi titolo, anche all'asta; vendita, permuta e trasferimento a titolo oneroso in genere, nonché locazione non finanziaria, di immobili rustici e urbani, compresi terreni e manufatti edilizi da demolire e/o ricostruire;
- e) costruzione, ristrutturazione e manutenzione in conto proprio e/o di terzi, di immobili a qualsiasi uso destinati; esecuzione di lavori edili in genere, e in particolare di lavori comunque connessi all'installazione di porte, infissi e serramenti;
- f) svolgimento di attività logistiche e di supporto a tutte quelle sopra indicate, comprese l'arredamento e allestimento di immobili;

La società, al solo fine di realizzare l'oggetto sociale, potrà:

- compiere operazioni di import-export e assunzione di agenzie e rappresentanze con e senza deposito, per prodotti italiani e stranieri di tutti i tipi;
- compiere operazioni mobiliari, immobiliari, commerciali, industriali e finanziarie (queste ultime in via non prevalente e non nei confronti del pubblico);
- assumere, sia direttamente che indirettamente, interessenze e partecipazioni, non al fine del collocamento, in società, consorzi e imprese aventi oggetto analogo, affine, connesso con il proprio



e/o comunque ritenuto strategicamente rilevante;

- chiedere finanziamenti e prestare avalli, fidejussioni, ipoteche e garanzie in genere anche al favore di terzi e per impegni altrui, in particolare a favore di società controllate, partecipate, o comunque di società facenti parte del medesimo gruppo, in modo che tale attività non si configuri come attività finanziaria nei confronti del pubblico; rilevare aziende o rami di aziende aventi oggetto analogo, affine o connesso con il proprio

La società può altresì assumere, non ai fini del collocamento, interessenze e partecipazioni in altre società o imprese di qualunque natura aventi oggetto analogo, affine o connesso al proprio, rilasciare fidejussioni e altre garanzie in genere, anche reali.

La proprietà di eventuali brevetti rinvenenti da attività di ricerca legate a particolari commesse sarà regolamentata da opportuni contratti con i committenti.

Tutte queste attività, ed altre operazioni che sono al servizio per realizzare l'attività principale, debbono essere svolte nei limiti e nel rispetto delle norme che ne disciplinano l'esercizio.

Art. 7. Capitale sociale

7.1. Il capitale sociale è determinato in, ALL 1.000.000,00 un milione di leke, equivalente a 10.000 euro.

7.2. Il capitale sociale è composto da una quota, con valore nominale 1.000.000 leke.

7.3. La partecipazione spettante a ciascun socio è proporzionale al conferimento effettuato.

7.4. Il capitale è posseduto al 100% dal socio unico della società.

7.5. La responsabilità del Socio unico si estende fino al valore del suo contributo al capitale sociale della società.

Art. 8. Aumento del capitale sociale

Il capitale potrà essere aumentato senza limiti, in qualsiasi momento in una o più volte.

L'aumento del capitale della società, si può effettuare solo con delibera dell'assemblea, all'unanimità, e relativa deliberazione dell'Assemblea dei soci dovrà essere adottata con le maggioranze previste per la modifica del presente statuto.

L'aumento del capitale sociale si potrà effettuare sottoscrivendo l'aumento della quota in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta.

Art. 9. Riduzione del capitale sociale

9.1. La società può ridurre il capitale sociale previa deliberazione dell'assemblea all'unanimità ma non sotto al livello minimo previsto dalla legge.

9.2. La riduzione del capitale è sopportata da ciascun socio proporzionalmente al valore nominale della quota di capitale posseduta.

Art. 10 Trasferimento delle quote

10.1. Le quote sono liberamente trasferibili tra i soci della società.



10.2. In caso di cessione a qualsiasi titolo, sia oneroso sia gratuito nella più ampia accezione del termine, compresa quindi la donazione delle quote sociali a soggetti diversi dai soci, le quote devono essere offerte in prelazione agli altri soci.

10.3. In tal caso il socio alienante dovrà comunicare per iscritto agli altri soci, mediante lettera raccomandata air, la volontà di vendere, con l'indicazione del prezzo, condizioni, modalità, nome del acquirente, e le generalità, e termini di cessione. Il diritto di prelazione dovrà comunque riferirsi alla intera quota offerta in vendita.

10.4. I soci avranno 15 giorni, dal ricevimento della lettera raccomandata air, per comunicare al socio alienante la loro eventuale volontà di esercitare o no il diritto di prelazione. Alla scadenza del termine stabilito, il diritto di prelazione a loro favore si intende rinunciato.

10.5. Nel caso in cui l'offerta sia accettata da più soci, la quota del socio alienante sarà suddivisa tra gli accettanti in misura proporzionale al valore nominale della quota di capitale da ciascuno di essi posseduta, salvo diverso accorda le parti.

10.6. In nessun caso l'offerente sarà tenuto ad accettare un esercizio soltanto parziale di prelazione.

10.7. In caso di mancato esercizio del diritto di prelazione, le quote potranno essere trasferite a terzi in tutto o in parte, previa deliberazione positiva dell'assemblea dei soci.

TITOLO III ORGANI SOCIETARI

Art. 11. Assemblea dei soci

L'organo decisionale della Società è l'Assemblea dei soci.

11.1. All'assemblea dei soci competono, a titolo esemplificativo e non esaustivo, le decisioni riguardanti le seguenti materie:

- Approvazione delle politiche commerciali della società e sorveglianza sulla loro esecuzione da parte dell'amministratore o degli amministratori, compresi i rapporti finanziari;
- Aumento e riduzione del capitale sociale;
- Scioglimento o fusione con altre società;
- Modifica dello statuto della società;
- Modifica della sede legale e denominazione societaria;
- Nomina gli esperti contabili, fiscali, autorizzati se necessario;
- Vendita o trasferimento delle quote del capitale sociale a altre parti;
- Ristrutturazione e scioglimento della società;
- Nomina e revoca dell'amministratore o degli amministratori della società;
- Approvazione del bilancio della società e del rapporto dell'amministratore/degli amministratori;
- Decisione sulla distribuzione dell'utile e le copertura delle perdite;
- Trasformazione della forma legale della società;
- Altre materie previste dallo statuto o dalla legge.

11.2. Ogni socio ha il diritto di partecipare alle assemblee, di far presentare la propria opinione e di esprimere il voto in proporzione al valore nominale della quota di capitale posseduta.



11.3. Ogni socio ha il diritto di farsi rappresentare da altra persona, anche non socio, munita di semplice procura scritta, attraverso il quale potrà esprimere il proprio voto.

Il socio non può conferire alcuna procura di voto per una parte del suo capitale, se vota di persona per la restante parte.

Art. 12. Convocazione di assemblea, quorum o delibere

12.1. L'assemblea deve essere convocata almeno una volta al anno entro 120 giorni di calendario della chiusura dell'esercizio per l'approvazione del bilancio, delle relazioni degli amministratori, e della relazione del esperto contabile nel caso che sia revisionato il bilancio.

12.2. L'assemblea può inoltre essere convocata in qualsiasi momento da uno degli Amministratori oltre che da uno o più soci che rappresentino almeno il 5% del capitale sociale.

12.3. L'assemblea deve essere convocata a mezza lettera raccomandata, con ricevuta di ritorno fatta pervenire ai soci nel domicilio risultante dal presente statuto, ed all'esperto contabile se nominato, almeno 7 giorni prima del giorno fissato per l'assemblea.

12.4. La convocazione deve contenere l'indicazione del tipo di assemblea, delle materie da trattare e da deliberare come ordine del giorno, del luogo, ora, data della prima e seconda convocazione.

12.5. L'assemblea può essere convocata anche fuori dalla sede sociale.

12.6. In caso di mancata riunione dell'assemblea nella prima convocazione per mancanza di quorum previsto nel presente articolo, l'Assemblea verrà convocata entro 30 giorni con lo stesso ordine del giorno.

12.7. E' ammessa la possibilità che le riunioni dell'assemblea si tengano per teleconferenza e videoconferenza, a condizione che tutti i partecipanti possano essere identificati e sia loro consentito di seguire la discussione e intervenire in tempo reale alla trattazione degli argomenti affrontati; verificandosi questi requisiti che dovranno risultare dal verbale di assemblea della società di adunanza, l'assemblea si considera tenuta nel luogo in cui si trova il Presidente e dove pure deve trovarsi il Segretario della riunione.

12.8. L'Assemblea si riterrà regolarmente convocata e costituita anche senza rispetto delle formalità di convocazione, se è presente o è rappresentato l'intero del capitale sociale.

12.9. Le deliberazioni dell'Assemblea dei soci, le quali richiedono una maggioranza semplice, sono valide se sono presenti i soci con diritto di voto che rappresentano più del 30% dell'intero capitale sociale della società.

12.10. Le deliberazioni dell'assemblea dei soci le quali richiedono una maggioranza qualificata, sono valide se sono presenti il 51% dell'intero capitale sociale. Escluso qui aumento e diminuzione del capitale sociale, la quale sarà una delibera da prendere solo con presenza del 100% del capitale sociale e con una delibera presa in unanimità.

12.11. L'Assemblea delibera la modificazione dello statuto, riorganizzazione e scioglimento della società, la distribuzione del utile, con $\frac{3}{4}$ dei voti dei soci che presentano il capitale della società.

12.12. Le decisioni del Assemblea, devono essere sottoscritte da tutti i soci presenti e dal segretario della riunione.

12.13. Il segretario viene nominato dall'Assemblea all'inizio della riunione. Il segretario della riunione potrà essere anche non socio.



Art. 13. Amministrazione

13.1. La società è amministrata da uno o più amministratori nominati con delibera dell'Assemblea dei Soci.

13.2. In caso la società viene amministrata da più di un amministratore, gli amministratori esercitano le loro competenze congiuntamente o separatamente, come previsto nel Verbale di assemblea per la nomina del secondo amministratore.

13.3. L'Amministratore rimane in carica per un periodo di 5 anni.

13.4. L'amministratore potrà delegare le sue competenze a terzi, anche socio della società o un gruppo di persone, tutto o parte delle sue competenze secondo questo statuto o secondo le condizioni e la situazione.

13.5. La delega potrà essere effettuata tramite una procura notarile nel caso sia obbligatorio per il motivo del quale viene esercitata la procura o tramite un'autorizzazione con timbro e sottoscrizione dell'Amministratore, specificando la materia in oggetto.

13.6. L'amministratore potrà esercitare tutti i poteri senza limite in conformità con quanto previsto dall'articolo 95 in continuo, della legge 9901, del 14.04.2008, "Per Commercianti e le Società Commerciali".

13.7. Il primo amministratore della società viene nominato Sig.ra CHIOCCA Carmela Goretti, cittadina Italiana, nata il 21.04.1978, a Pozzuoli(NA), residente in Via Caio Vestorio, 10- Pozzuoli, Napoli, identificato da passaporto con numero YC5577599, per un periodo di 5 anni con diritto di rinnovo con approvazione dell'assemblea.

Art. 14. Esercizio sociale

L'esercizio finanziario della società decorre dal 1° gennaio e termina il 31 Dicembre. In via eccezionale, il primo anno di attività della società decorre dalla data di iscrizione della società e termina 31 dicembre.

Art. 15. Scioglimento e liquidazione della società

Lo scioglimento della società può essere fatto per quanto segue:

- a) Fine della durata dell'attività previsto nell'atto costitutivo;
- b) Con la decisione dell'Assemblea dei soci;
- c) L'apertura di una procedura d'insolvenza;
- d) Con la decisione del giudice;

Il Liquidatore è tenuto a riportare sullo stato delle voci dell'attivo e del passivo della società in ulteriori operazioni di liquidazione e il tempo richiesto per la chiusura del processo di liquidazione.

Al termine di questo processo, i soci verranno informati sul saldo finale e la chiusura della procedura di liquidazione.

Art. 16. Reddito, ripartizione dei dividendi

La società creerà fondi di riserva per la realizzazione dell'oggetto sociale.

L'utile dopo la chiusura dell'esercizio e dopo il pagamento delle imposte, possono essere diviso ai soci.



Art. 17. Clausola di chiusura

Tutte le controversie che possono insorgere durante l'attività della società, se non risolta in via amichevole, le parti concordano nel rivolgersi all'Arbitrato commerciale preso il Centro Albanese di Mediazione e Arbitrato Commerciale, tranne quando competente a risolvere le controversie ai sensi di legge è la corte albanese di Tirana o dove la società potrà avere sede secondarie.

Questo statuto è redatto in tre copie originali in albanese e italiano con lo stesso valore giuridico.

01/02/2025

SOCIO UNICO DELLA SOCIETA

Carmela Gofetti CHIOCCA

Chioce Carmela Gofetti